VENDIM
Nr.1720, datë 29.10.2008

PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV, PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË I ARRIJNË KËTO NIVELE, SI DHE PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv dhe mënyra e shpërblimit

Sportistët e nivelit të lartë klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive, të arritura në veprimtaritë, ndërkombëtare dhe kombëtare.

1. Veprimtaritë ndërkombëtare:

1.1 Kritere për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv, për të rritur, në sportet individuale, në përbërje të ekipit kombëtar dhe të ekipeve kombëtare të sporteve kolektive, si futboll, basketboll, volejboll, atletikë, gjimnastikë, not, peshëngritje, boks, mundje e qitje, të jenë rezultatet e arritura në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare, sipas klasifikimeve përfundimtare, të përcaktuara në rregulloret ndërkombëtare të këtyre sporteve, si më poshtë vijon:

a) Sportisti i cili thyen rekord olimpik;

b) Sportisti i cili thyen rekord botëror;

c) Sportisti i cili thyen rekord europian;

ç) Vendi i parë deri në vendin e pestë, në Lojërat Olimpike;

d) Vendi i parë deri në vendin e tretë, në kampionate botërore;

dh) Vendi i parë deri në vendin e tretë, në kampionatin europian;

e) Vendi i parë në Lojërat Mesdhetare.

Klasifikimi i ekipeve në sportet individuale nuk merret parasysh në kategorizimin e mësipërm.

1.2. Sportistët, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1. të këtij kreu, të shpërblehen sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.3. Kategoria e të rinjve, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1.1. të këtij kreu, të shpërblehen ne masën 25 për qind të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.4. Trajnerët e sportistëve të nivelit të lartë shpërblehen në masën 30 për qind, të vlerës së përcaktuar për sportistët fitues, sipas kategorizimeve të vlerave, dhënë në tabelën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.5 Sportistët e përcaktuar në pikën 1.1. të këtij kreu, përfitojnë të drejtën e kryerjes së studimeve akademike, sipas një plani individual, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

1.6. Klasifikimi i ekipeve si dhe shuma përfituese, në sportet kolektive, është përcaktuar në tabelën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nga kjo shumë përcaktohet shpërblimi i sportistëve në sportet kolektive, i cili është individual dhe bazohet në kontributin e secilit.

1.7. Këshilli Kombëtar i Sportit përcakton masën e shpërblimit, për fituesit e garave ndërkombëtare, bazuar në kriteret e përcaktimit të nivelit të rezultatave dhe të pjesëmarrjes së tyre.

1.8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për pikat 1.1 e 1.6, të këtij kreu, do të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

1.9. Për veprimtaritë e tjera të rëndësishme ndërkombëtare, shpërblimi të përballohet nga buxheti i vitit, fondi për sportin, në dispozicion të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të federatave sportive, përkatëse, deri 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Veprimtaritë kombëtare

2.1. Kritere për përcaktimin e nivelit të lartë sportiv në veprimtaritë kombëtare janë rezultatet e arritura në këto veprimtari, si më poshtë vijon:

a) Sportisti, i cili thyen rekordin kombëtar;

b) Vendi i parë në kampionatin kombëtar.

2.2 Shpërblimi, sipas masës së përcaktuar në tabelën III, që i bashkëlidhet këtij vendimi, jepet dhe mbulohet nga federatat përkatëse.

II. Përfitimi i trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë

1. Sportistët pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare të kategorisë së parë dhe superiore, për përgatitjen e tyre përfitojnë trajtim ushqimor dhe mjekësor.

2. Trajtimi ushqimor jepet në para ose në natyrë. Trajtimi ushqimor vjetor është deri 2000 (dy mijë) lekë në ditë, për 25 ditë në muaj. Trajtimi mjekësor për medikamente dhe rehabilitim është deri 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj.

3. Trajtimi ushqimor dhe mjekësor, mbulohet, plotësisht ose pjesërisht, nga klubet sportive, me fondet e pushtetit vendor a të ardhura të tjera, të ligjshme.

4. Për sportistët e përcaktuar në pikën 1.1, të kreut I, federatat sportive kanë të drejtë të kompensojnë trajtimin ushqimor dhe mjekësor, maksimal, nëse klubi përkatës nuk mund ta mbulojë atë.

5. Federatat dhe klubet kanë të drejtë të grumbullojnë ekipet e tyre përfaqësuese për veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare. Vlera ditore për akomodim dhe ushqim të jetë deri në 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, deri 50 ditë në vit.

6. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.305, datë 24.5.2006 i Këshillit të Ministrave "Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv dhe mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që arrijnë këto nivele", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA I
KLASIFIKIMI NË RENDITJEN INDIVIDUALE, SPORTET INDIVIDUALE
DHE SHPËRBLIMET

Rekord olimpik		Deri 15 000 000 lekë
Rekord botëror		Deri 15 000 000 lekë
Rekord europian		Deri 8 000 000 lekë
Lojërat olimpike	Vendi i parë	Deri 10 000 000 lekë
Lojërat olimpike	Vendi i dytë	Deri 7 000 000 lekë
Lojërat olimpike	Vendi i tretë	Deri 5 000 000 lekë
Lojërat olimpike	Vendi i katërt	Deri 3 000 000 lekë
Lojërat olimpike	Vendi i pestë	Deri 2 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë	Deri 10 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i dytë	Deri 6 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i tretë	Deri 4 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i parë	Deri 4 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i dytë	Deri 2 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i tretë	Deri 1 000 000 lekë
Lojërat mesdhetare	Vendi i parë	Deri 1 000 000 lekë

TABELA II
KLASIFIKIMI NË RENDITJEN EKIPORE DHE SHPËRBLIMET

Lojërat olimpike	Vendi i parë deri i treti	Deri 20 000 000 lekë
Kampionat botëror	Vendi i parë deri i treti	Deri 15 000 000 lekë
Kampionat europian	Vendi i parë deri i treti	Deri 7 000 000 lekë

Kampionat Lojërat mesdhetare	Vendi i parë	Deri 2 000 000 lekë

TABELA III
SHPËRBLIMET PËR FITUESIT NË VEPRIMTARITË KOMBËTARE

Rekord kombëtar		Deri 30 000 lekë
Kampion kombëtar	Vendi i parë	Deri 20 000 lekë
Ekipi kampion kombëtar Në lojëra	Vendi i parë Vendi i dytë dhe i tretë	Deri 200 000 lekë Deri 100 000 lekë